

VENDIM
Nr. 17, datë 2.3.2018

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME LIBOHOVË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë, me:
Drejtues ligjor: Aldi Sinani;
Drejtues teknik: Kristaq Jorgaqi.
2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të kësaj shoqërie është Njësitë Administrative Libohovë (Bashkia Libohovë).
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare). Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Libohovë duhet të aplikojë për zgjerim të zonës së shërbimit për njësitë administrative Qendër, Libohovë dhe Zagorie, menjëherë pas reflektimit të tyre në QKB.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatime Imeraj